



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE
KRYETARI

Nr. 1238 Prot.

Vlorë, më 25 / 04 /2016

KONTRATË MBIKQYRJE PUNIMESH NDËRTIMI

(Pikë panoramike dhe sportive në Llogara)

Titulli i Kontratës: “Mbikëqyrje Punimesh në objektin : “Pikë panoramike dhe sportive në Llogara”.

Kjo Kontratë është lidhur më 25 / 04 /2016 midis Këshillit të Qarkut Vlorë i përfaqësuar nga **Z. Sadrit DANAJ** tani e tutje i referuar si “Investitor ” dhe bashkimit të operatorëve “**Derbi –E” sh.p.k.** me seli në Dibër, me NIPT. K77916947A dhe “**Dea-Studio” sh.p.k** me seli ne Tiranë, me NIPT. K31512110L të përfaqësuar nga drejtuesi ligjor “**Dea – Studio**”, **Z. Ervin Taçi**, tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi” sipas prokurës së posaçme Nr. Rep. 2015, Nr. Kol. 105/3.

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë : 14.04.2016 bie dakord të realizojë Punët, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:


- Këtë Formular Kontrate
- Formulari i Ofertës i paraqitur nga Ofertuesi

Si dhe pasi Investitori pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej 443 639 (katërqind e dyzetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH për realizimin e Punëve;

Palët bien dakort si më poshtë:

1. Kontraktuesi është i detyruar të kryejë Punët për Investitorin, siç kërkohet në këtë Kontratë.
2. Investitori është i detyruar të paguajë për Punët, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
3. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
4. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Sot, më datë 25 / 04 /2016 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate



Sot, më datë 25 / 04/2016 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate

“DERBI-E”shpk & “DEA-STUDIO”

AUTORITETI KONTRAKTOR

ADMINISTRATORI

Ervin TAÇI



Kyetari i Këshillit të Qarkut Vlorë

Sadrit DANAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT VLORE
KRYETARI

K O N T R A T Ë

Nr. 1238 datë 25 / 04 /2016

Sot, me datë 25 / 04 /2016 , lidhet kjo kontratë për procedurën e blerjes me vlerë të vogël: **“Mbikqyrje punimesh për tenderin me objekt « Pikëpanoramike dhe sportive në Llogara»“** ndërmjet palëve, **Këshilli i Qarkut Vlorë** në këtë kontratë me cilësinë e Investitorit, përfaqësuar nga **Z. Sadrit DANAJ** dhe bashkimit të operatorëve **“Derbi –E” sh.p.k.** me seli në Dibër, me NIPT. K77916947A dhe **“Dea-Studio” sh.p.k** me seli ne Tiranë, me NIPT. K31512110L të përfaqësuar nga drejtuesi ligjor i **“Dea – Studio”**, **Z. Ervin Taçi**, tani e tutje i quajtur si **“Kontraktuesi”** sipas prokurës së posaçme Nr. Rep. 2015, Nr. Kol. 105/3.

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës “Blerje me vlerë të vogël” me objekt: **“Mbikqyrje punimesh për tenderin me objekt « Pikë panoramike dhe sportive në Llogara»“**
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.



- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Investitor” do të thotë Investitor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës


- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Investitor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Investitor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtun ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.



Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Investitor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Investitor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Investitor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Investitor nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Investitor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Investitor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Investitor, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Investitor

7.5 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Investitor të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Specifikime dhe Skicime



- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisi të gjitha specififikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Investitor dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specififikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 10 Lejet dhe Liçensat

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Investitor përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Investitor zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Investitor është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Investitori

Neni 14 Çmimi i Kontratës

- 14.1 Çmimi i kontratës është 443 639 (katërqind e dyzetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH dhe 532 367 (pesëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë me TVSH.

Neni 15 Afatet e Pagesës

- 15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifkohet në kontratë.
- 15.2 Monedha e pageses do të jete **LEK**.
- 15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Investitori me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me:

a) faturë tatimore



Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Investitori.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 29 Baza Ligjore

- 29.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

- 30.1 Investitor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
- 30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31 Përfaqësimi i Palëve

- 31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32 Lajmërimet

- 32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 33 Llogaritja e Afateve

Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të disa rasteve.



“DERBI-E”shpk & “DEA-STUDIO”

AUTORITETI KONTRAKTOR

ADMINISTRATORI

Ervin TACI

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë

Sadrit DANAJ



KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES

Blerje me vlerë të vogël

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do të mbizoterojnë ato të Kushteve të veçanta të kontrates.

Neni 1 Përkufizime

1.1 Investitor është **Këshilli i Qarkut Vlorë**

1.2 Kontraktuesi është dhe bashkimit të operatorëve “**Derbi –E**” sh.p.k. me seli në Dibër, me NIPT. K77916947A dhe “**Dea-Studio**” sh.p.k me seli ne Tiranë, me NIPT. K31512110L të përfaqësuar nga drejtuesi ligjor i “**Dea – Studio**”, **Z. Ervin Taçi**, tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi” sipas prokurës së posaçme Nr. Rep. 2015, Nr. Kol. 105/3.


Neni 3 Fillimi i Kontrates

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më datën e nënshkrimit të formularit të kontratës.

Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve

Shërbimet do të kryhen në **Llogara, Vlorë**

Neni 5 Kërkesat e Raportimit



6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor si dhe këto palë bien dakort si më poshtë vijon:

1. Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet për ndjekjen e realizimit pikë për pikë të kontratës të nënshkruar midis Kontraktorit dhe Investitorit për realizimin e fazave të ndryshme të zbatimit, të respektimit të afatit të dorëzimit dhe kostos së objektit.
2. Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet për ndertimin e objektit në përputhje me projektin dhe Kushtet Teknike të zbatimit në fuqi, për mbikqyrjen dhe përshkrimin e zbatimit të projektit, cilësinë e materialeve të përdorura që të plotësojnë kërkesat e objektit.
3. Mbikqyrësi i punimeve njofton me shkrim investitorin për çdo problem që mund të lind gjatë zbatimit të punimeve konform kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta të kësaj kontrate.
4. Mbikqyrësi i punimeve duhet të ruajë dhe të kontrollojë të gjitha dokumentat e përcaktuara në ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “ Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” si dhe në Udhëzimin nr.1 date 16.06.2011 për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “ Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar, që Kontraktori do të depozitohet në Këshillin e Qarkut Vlorë si dhe librin e kantjerit i cili duhet të jetë i nënshkruar prej tij.
5. Mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të objektit ngarkohet t’i japi instruksione dhe urdhëra me shkrim Kontraktorit sa herë që e sheh të nevojshme. Kontraktori është i detyruar t’i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e lëshuar nga ana e Mbikqyrësit të punimeve.
6. Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtën që me miratimin e Investitorit të japi urdhërat me shkrim për ndryshimet që ai i sheh të arsyeshme që duhen bërë gjatë zbatimit të veprës. Në raste urgjente, Mbikqyrësi i punimeve mund të urdhërojë me shkrim zbatimin e menjëhershëm të ndryshimeve.
7. Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantjerit ose të specialistëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
8. Materialet që do të përdoren në vepër duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kontratës, ato mund të përdoren në vepër vetëm me miratimin e Mbikqyrësit i punimeve. Materialet e ardhura në kantjer që nuk pranohen nga Mbikqyrësi i punimeve zëvendësohen me të tjera me shpenzimet e sipërmarrësit.
9. Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të vendosë të bëjë prova të materialeve për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Kontraktorit.
10. Kur Mbikqyrësi i punimeve mendon se ka defekte të konsiderueshme ose në pjesë të tjera të veprës, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë Mbikqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të Kontraktorit, në rast të kundërt Kontraktori ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
11. Kur urdhërohet nga Mbikqyrësi i punimeve, Kontraktori duhet të prishë dhe ribëjë me shpenzimet e veta punimet e kryera jo me cilësinë e parashikuar ose me materiale sipas përshkrimeve të projektit dhe standarteve në fuqi.
12. Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet kur gjykon se ka shkaqe për këtë. Kjo ndërprerje nuk duhet të zgjasë më shumë se 1/3 e kohëzgjatjes së punimeve sipas kontratës së nënshkruar por në çdo rast jo më shumë se 6 muaj.
13. Kur investitori lejon shmangie në përmasa ose cilësi, Mbikqyrësi i punimeve gjithmonë në qoftë se vepra është e pranueshme, duhet të zbatojë një zbritje të çmimeve në kontabilitet dhe si vlerësim përfundimtar në kolaudim.
14. Mbikqyrësi i punimeve duhet t’i paraqesë Investitorit materialet e sipërpërmendura të marra në dorëzim nga Kontraktori së bashku me relacionin e vet.




15. Pas përfundimit të punimeve, brenda 30 ditëve, Mbikqyrësi i punimeve, duhet të depozitojë në Këshillin e Qarkut Vlorë, një relacion në dy kopje rreth zbatimit të punimeve me karakteristikat dhe cilësinë e materialeve të përdorura në vepër shoqëruar me :
- Certifikatat e provave të materialeve të përdorura lëshuar nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.
 - Për objektin çdo të dhënë për plotësimin në vepër të kësaj strukture.
 - Deklaratë që objekti është zbatuar në përputhje me projekt – zbatimin dhe K.T.Z.
16. Mbikqyrësi i punimeve asiston në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të veprës dhe firmos proces-verbalin e kolaudimit.
17. Mbikqyrësi i punimeve është përgjegjës për fondin e veprës. Situacionet e paraqitura nga Kontraktori pas kryerjes së punimeve në faza të ndryshme mund të paguhen nga Investitori vetëm pasi të jenë shqyrtuar dhe firmosur nga Mbikqyrësi i punimeve.
18. Mbikqyrësi i punimeve nuk duhet të ketë lidhje pune, gjaku apo interesash as me Kontraktorin dhe as me kolaudatorin , në të njëjtën kohë ai nuk duhet të ketë asnjë pengesë të këtij lloji me projektuesin. Për këtë qëllim Mbikqyrësi i punimeve do të bëjë një deklaratë me shkrim për Investitorin.
19. Kur vërehen shkelje të dispozitave ligjore, Investitori ka të drejtë t'i urdhërojë Mbikqyrësit të punimeve pezullimin e punimeve dhe i lind e drejta të kryej prishjen e kontratës duke i kërkuar dëmshpërblim Mbikqyrësit të punimeve për dëmin e shkaktuar prej tij.
20. Afati i kësaj kontrate shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së lidhur ndërmjet Investitorit dhe Kontraktorit për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.
21. Pagesa e Mbikqyrësit të punimeve do të kryhet në përfundim të punimeve brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga paraqitja e faturës.
22. Mbikqyrësi i punimeve gjatë gjithë veprimtarisë duhet të zbatojë të gjitha dispozitat e parashikuara në këtë kontratë si dhe kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 8402, dt.10.09.1998 i ndryshuar si dhe në Udhëzimin nr.1 datë 16.06.2011 për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “ Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndertimit, të ndryshuar, dhe mban përgjegjësi për mos respektimin e tyre.
23. Mosmarrëveshjet që lindin midis palëve zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt, kompetentë për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Vlorë.

Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Investitori me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: _____

Neni 8 Kushtet e Pagesës

- 8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _____ ditëve nga data e arritjes së marrëveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.
- 8.3 Monedha e pagesës do të jetë Lekë. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 9 Pagesa Paraprake



- 9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.
- 9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.
- 9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: _____

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

“DERBI-E”shpk & “DEA-STUDIO”

AUTORITETI KONTRAKTOR

ADMINISTRATORI
Ervin TAÇI



Handwritten signature of Ervin Taçi in blue ink over a blue stamp of "DEA-STUDIO". The stamp includes the text "DEA-STUDIO" and "KESHILLI I QARKUT VLORE".

Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë
Sadrit DANAJ



Official blue stamp of the Vlorë District Council (KESHILLI I QARKUT VLORE) and a handwritten signature in blue ink.